



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 23.11.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 21.11.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : Ndërtimi i terreneve sportive “ , Nr. i prokurimit- 632-22-110555-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-121-521, nxjerr:

### V E N D I M

1. **Aprovohet** si pjesërisht e bazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”, e dt.21.11.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i terreneve sportive “ , Nr. i prokurimit- 632-22-110555-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-121-521, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES , te AK – së, të datës 16.11.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
2. **Anullohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë 16.11.2022;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të kthej lëndën në ri-vlerësim;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

### A r s y e t i m

Me dt.21.11.2022, Operatori Ekonomik N.SH.T. “VIKTORY COM”, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: “Ndërtimi i terreneve sportive “ , Nr. i prokurimit- 632-22-110555-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-121-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 23.11.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit të Kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik N.SH.T. “**VIKTORY COM**”, të dt.21.11.2022, Autoriteti kontraktues, konstaton se pretendimet e Operatorit në fjalë, janë pjesërisht të bazuara, prandaj vendos që të kthej lëndën në ri-vlerësim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

**Faton Gutaj**  
  
**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës